



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Universitetit të Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Universitetit të Prishtinës (UP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Universitetit të Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

- A1 Në raportin financiar vjetor të UP-së për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 janë identifikuar gabime materiale në paraqitjen e saktë të të dhënave financiare.
- A2 Detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 1,232,818€ pasi që në regjistër ishin të përfshira raste të cilat nuk i plotësonin kriteret për prezantim si detyrime kontigjente.
- A3 Në PFV 2024, UP kishte raportuar si detyrim të papaguar shumë prej 99,969€, e cila ishte paguar në dhjetor 2024, duke rezultuar në paraqitje jo të saktë të gjendjes financiare në fund të vitit.
- A4 UP në vitin 2024 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 187,472€ në kategori ekonomike jo adekuate.
- B1 Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar në vlerën e plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat që janë në shfrytëzim të UP-së. Këto pasuri përfshinin tri komplekse universitare, dy objekte dhe një parcelë toke. Kjo e kishte nënvlerësuar në vlerë materiale pasurinë e raportuar në PFV-të për vitin 2024, raportin për pasuri kapitale neni 19.3.1.  
Për shkak të natyrës së çështjes auditori nuk ka arritur të identifikoj vlerën financiare të mos-regjistrimit por gabimi konsiderohet material në aspektin e keq-deklarimit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Universitetit të Prishtinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

B2 Në gjashtë (6) pagesa në vlerë totale prej 105,219€ janë identifikuar vonesa në pagesën e faturave nga 31 deri në 127 ditë pas afatit ligjor për pagesë prej 30 ditësh.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretar i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretar i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Rektori i Universitetit të Prishtinës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Universitetit të Prishtinës.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Universitetit të Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Universitetit të Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Universitetit të Prishtinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

UP në vitin 2024 ka shpenzuar 95% të buxhetit final, duke shënuar një rritje prej 2% krahasuar me vitin 2023. Çështjet e identifikuara që kanë ndikuar te opinionin i pasqyrave financiare janë: mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente, mangësi në prezantimin e të dhënave financiare në PFV, klasifikimi jo adekuat të shpenzimeve, mangësi në raportimin e detyrimeve të pa paguara, si dhe nënvlerësimi i pasurive kapitale.

Te konkluzioni i pajtueshmërisë ka ndikuar vonesa në pagesën e faturave.

Ndërsa çështjet tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë janë: mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, menaxhimi i kontratave jo përmes e-prokurimit, si dhe mungesa e njoftimit paraprak.

Po ashtu, ne si ekip kemi dhënë këshilla për përmirësimin e draft pasqyrave financiare vjetore të UP për vitin 2024, të cilat nuk janë përmirësuar në tërësi versionin final të PFV-ve.

Raporti ka rezultuar me gjithsej nëntë (9) rekomandime, prej të cilave gjashtë (6) rekomandime janë të reja dhe tri (3) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Mangësi në prezantimin e të dhënave financiare në Pasqyrat Financiare Vjetore

##### Gjetja

Neni 6 i Rregullores së MF nr. 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore parasheh se: "Organizatata buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Neni 14, Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit, pika 6 parasheh: "Ndryshimet buxhetore gjatë vitit fiskal prezantohen si tabelë e veçantë tek shpalosja e shënimeve në formën e një analize të ndryshimeve ndërmjet buxhetit fillestar dhe përfundimtar sipas kategorive". Po ashtu, neni 15, Shënime për pasqyrat financiare, pika 3: "Secili zë në PFV duhet të jetë i ndërlidhur me informatat relevante të dhëna në shënime dhe të komentohet me përshkrim të shumave të paraqitura në raport".

Përkundër këshillave tona gjatë procesit të auditimit lidhur me përmirësimin e gabimeve në pasqyrat financiare vjetore të UP-së, ne kemi identifikuar mangësi në PFV për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024, të cilat janë shpalosë si në vijim:

- Tek Neni 14, shënimi 14 për grantet e përcaktuara të donatorëve, në kolonën për vitin 2024, vlera ishte nënvlerësuar për 6,514€, e cila

ishite reflektuar edhe në nenin 14.6;

- Neni 19.3.3, stoqet, ekziston një mos harmonizim i shënimeve kontabël në mes të stoqeve të prezantuara në pasqyrat financiare dhe regjistrin të stoqeve në e-pasuria, sepse në PFV është prezantuar vetëm vlera e materialit shpenzues; si dhe
- Neni 21, Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara, vlera e të hyrave të bartura është mbivlerësuar për 127,923€.

Për më tepër, PFV-të nuk përmbanin shpalosjet apo komentet për të dhënat në shënime dhe nuk ishin komentuar me përshkrimet relevante të shumave që ndërlidhen me vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare vjetore.

Mangësitë në PFV kanë ndodhur për shkak të kontrolleve jo të duhura si dhe mos zbatimit me përpikëri të kërkesave të rregullores për raportim financiar.

#### **Ndikimi**

Mangësitë e identifikuar kanë rezultuar në prezantim jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare vjetore dhe në opinion të modifikuar të auditimit.

#### **Rekomandimi A1**

Rektori duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që mangësitë dhe gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2025, respektivisht PFV-të nuk do të dorëzohen para se t'i nënshtrohen një rishikimi të detajuar nga ana e menaxhmentit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Mbivlerësimi i Detyrimeve Kontigjente**

#### **Gjetja**

Sipas rregullores MF - Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, respektivisht Neni 6 Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore, kërkon që organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Po ashtu, Neni 18 Raport për detyrimet kontigjente, përcakton që organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Gjatë testimeve tona, kemi evidentuar pasaktësi në raportimin e detyrimeve kontigjente në vlerë 1,232,818€. Këto janë si në vijim:

- Obligimi ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në vlerë 490,000€ ishte raportuar gabimisht në vend që të ishte pjesë e raportit për detyrimet e pa paguara. Gjatë kohës sa ishim në auditim përmes konfirmimit të drejtpërdrejt nga ana e ATK-së lidhur me bilancet mbyllëse shuma që konsiderohej borxh arrinte vlerën 510,460€ apo 20,460€ më e lartë se sa që ishte deklaruar;
- Shuma në total prej 725,369€ ishte prezantuar si detyrim kontigjent në komulativ, bazuar në vendimet e këshillit drejtues me numër protokollit 3/324 dhe 3/821 në emër të detyrimeve të stafit akademik dhe administrativ sipas kontratës kolektive. Mirëpo, sipas zyrës ligjore kjo vlerë nuk ishte pjesë e proceseve gjyqësore dhe as e përfshirë në regjistrin e tyre; si dhe
- Shuma e përbashkët e dy rasteve prej 17,449€, pavarësisht që ishin

paguar gjatë vitit, të njëjtat ishin prezantuar si detyrime kontigjente.

Po ashtu kemi vërejtur diferencë në detyrime kontigjente në mes PFV dhe formatit ndihmës të raportit vjetor, e cila ishte si rezultat i gabimeve teknike rreth përdorimit të ndarjes së numrave decimal me "." dhe "," që ka pamundësuar përfshirjen e disa shumave në vlerën totale.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrës ligjore dhe zyrës së financave në kuadër të UP-së si dhe dobësive në kontrolle lidhur me mbajtjen e evidencave të plota dhe raportimit të saktë të tyre në PFV.

**Ndikimi** Shpалosja jo e plotë dhe e saktë e detyrimeve kontigjente ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë, duke pasur ndikim negativ në vendimmarrje.

**Rekomandimi A2** Rektori duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A3 - Mbivlerësimi i detyrimeve të pa paguara**

**Gjetja** Sipas Rregullores MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 17, pika 3, përcakton që organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Në PFV për vitin 2024, UP kishte raportuar si detyrim të papaguar shumën në vlerë 99,969€. Mirëpo, gjatë testimave tona, kemi vërejtur që kjo vlerë ishte paguar në fillim të dhjetorit e ndarë në dy pagesa (70,000€ dhe 29,968.64€ me datën 04.12.2024). Si rezultat, kjo shumë ishte përfshirë gabimisht si detyrim në PFV, duke mbivlerësuar vlerën e detyrimeve të papaguara.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të duhur në procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe pakujdesisë në përditësimin e të dhënave për detyrimet e shlyera para përfundimit të vitit.

**Ndikimi** Raportimi i pasaktë i detyrimeve të papaguara ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre, duke bërë që informatat e prezantuara në pasqyrat financiare vjetore të mos jenë të plota dhe të saktë.

**Rekomandimi A3** Rektori duhet të sigurojë kontrollet e brendshme në procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke siguruar që regjistri i detyrimeve të papaguara të azhurnohet në mënyrë të rregullt dhe të saktë. Gjithashtu, në pasqyrat financiare duhet të përfshihen vetëm faturat që realisht mbesin të papaguara deri në fund të periudhës raportuese.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A4 - Keq klasifikimi i shpenzimeve**

**Gjetja** Sipas neni 18, pika 3 e Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike kërkon që shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për Planin Kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të siguroj që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Në vitin 2024, UP ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 187,472€ në kategori ekonomike jo adekuate.

- Nga kategoria e mallra dhe shërbime përmes vendimeve gjyqësore ishin paguar paga në vlerë të përbashkët 64,603€;
- Nga kategoria e mallra dhe shërbime ishin paguar 24,747€ pajisje të TI që e kalonin vlerën mbi 1000€, e të cilat për nga natyra i takonin kategorisë së investimeve kapitale; si dhe
- Nga investimet kapitale ishin paguar paga me vendime gjyqësore në vlerë 98,122€.

Keq klasifikimi ishte rezultat i planifikimit jo të duhur ekonomik dhe si rezultat i ekzekutimit të pagesave nga Thesari për pagesat e vendimeve gjyqësore dhe përbarimore.

**Ndikimi** Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate ekonomike ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve, duke shkaktuar mbivlerësim/nënvlerësim në kategoritë ekonomike përkatëse.

**Rekomandimi A4** Rektori duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B1 - Mos regjistrimi i pronave në regjistrin e pasurive kapitale**

**Gjetja** Neni 6 paragrafi 3 i Rregullores nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria", të njëjtat duhet të shpalosen në PFV tek neni 19.

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000 nuk është prezantuar në vlerën e plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat të cilat janë në shfrytëzim të UP-së. Këto prona janë si në vijim:

- Objekti dhe parcela e Rektoratit të UP-së;
- Kompleksi universitar (objektet e bibliotekës kombëtare; fakulteti filozofik, filologjik, shkencat natyrore, edukatës fizike),
- Kompleksi i Fakultetit Ekonomik, Juridik dhe i Edukimit;
- Kompleksi i Fakultetit të Vjetër Teknik (seksioni i arkitekturës); dhe

- Objekti i ri i fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV).

Duhet theksuar se, këshilli drejtues i UP-së kishte emëruar komisionin ndërinstitucional për çështje pronësore të UP-së, i cili kishte arritur t'i siguronte dokumentet e parcelave për objektet e UP-së. Megjithatë, këto prona ende nuk janë regjistruar në regjistrin zyrtar të pasurive. Për shkak të natyrës së çështjes, auditori nuk ka arritur të identifikoj vlerën financiare të mos-regjistrimit por gabimi konsiderohet material në aspektin e keq-deklarimit.

Kjo çështje është trajtuar në raportet tona tashmë e disa vite me radhë dhe konsiderojmë se gjendja e trashëguar ndër vite është si rezultat i mungesës së veprimeve konkrete të menaxhmentit.

**Ndikimi**

Mos regjistrimi i të gjitha pronave në regjistrin e pasurisë ndikon në prezantim jo të plotë dhe të saktë të pasurive në PFV.

**Rekomandimi B1**

Rektori duhet të ndërmarrë veprime për identifikimin e pronave dhe evidentimin e tyre në regjistër, me qëllim që të gjitha pasuritë kapitale që i takojnë dhe janë në shfrytëzim të UP-së të përfshihen në regjistrat e pasurive dhe të prezantohen në PFV për vitin 2025.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave

- Gjetja** Sipas nenit 17.1 të rregullores MF-Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë, për mallrat dhe shërbimet e furnizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore.
- Gjatë auditimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kemi hasur në gjashtë (6) pagesa në vlerë totale prej 105,219€ në të cilat kishte vonesa në pagesa nga 31 deri 127 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh. Dy prej këtyre pagesave, ishin fatura të cilat ishin raportuar si detyrime të papaguara në fund të vitit, dhe pagesa e tyre ishte bërë në vitin 2025.
- Shkaqet për vonesa ishin për shkak të kontrolleve joadekuate në ekzekutimin e pagesave, planifikimi jo i mirë i buxhetit si mos përcjellja me kohë e faturave në zyrë të financave.
- Ndikimi** Mos kryerja e pagesave brenda afatit ligjor, mund të ndikojë që operatorët ekonomik t'i drejtohen përmbauesve apo gjykatave dhe se realizimi i tyre përmes këtyre procedurave mund të krijojë shpenzime shtesë për buxhetin e UP-së.
- Rekomandimi B2** Rektori duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti përfundimtar për paga dhe mëditje ishte 19,106,325€, nga i cili ishte shpenzuar 98%. Numri i të punësuarve sipas ligjit të buxhetit ishte 2,081, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 1,727. Gjatë vitit 2024, nuk ishin zhvilluar procedura të rekrutimit.

#### Çështja A5 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre

**Gjetja** Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 35 Ushtruesja/i e/i detyrës, paragrafi 3 Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë

Gjatë auditimit kemi vërejtur që dy pozita mbulohen me ushtrues detyre/zëvendësues për një periudhë më të gjatë se periudha e lejuar me ligj. Këto janë si në vijim:

- Pozita e drejtorit të Zyrës për Teknologji të Informacionit; dhe
- Pozita e drejtoreshës së Zyrës për Shërbime të Studentëve në Administratën Qendrore të UP-së.

Kjo kishte ndodhur pasi UP nuk ka marrë masa që pozitat të cilat janë vakante dhe që janë duke operuar me ushtrues detyre t'i plotësoj duke respektuar procedurat ligjore të rekrutimit dhe afatet e përcaktuara ligjore.

**Ndikimi** Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor rrezikon që pozitat e ndryshme të mbahen nga persona që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara/përcaktuara për pozitat adekuate.

**Rekomandimi A5** Rektori duhet të sigurojë respektimin e afateve ligjore të përcaktuara me ligj për ushtrues detyre si dhe të zhvillojë procedurat e rekrutimit në përputhje me kërkesat ligjore për plotësimin e pozitave që mbahen me ushtrues detyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,321,069€, prej tyre ishin shpenzuar 5,166,056€, ose 97%. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për ndërtesat administrative afariste, objektet arsimore, pajisje të teknologjisë informative dhe pajisje tjera, softuer dhe mobile.

### Çështja A6 - Mungesa e njoftimit paraprak

**Gjetja** Sipas nenit 39 të LPP-së, kur një AK ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej 500,000€ e më tepër, AK duhet të përgatisë njoftimin paraprak. Njoftimi paraprak është ndihmesë në transparencë dhe është në të mirë të OE që të përgatiten dhe njoftohen për prokurimet e mundshme që do t'i zhvilloj AK. Po ashtu, kjo i mundëson AK-ve të zbatojnë afatet e shkurtuara pa pasur nevojë për aprovim të procedurave të përshpejtuara.

UP kishte planifikuar gjashtë procedura të prokurimit me kontrata të mëdha mbi 500,000€, nga të cilat ne kemi testuar dy që kanë të bëjnë me "Furnizim me pajisje laboratorike për FIN" në vlerë 650,000€ dhe "Furnizimi me pajisje laboratorike për FIM" në vlerë 650,000€. Për asnjërën prej këtyre procedurave, UP nuk kishte përgatitur dhe publikuar njoftimin paraprak.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e suspendimit të zyrtarëve kyç në departamentin e prokurimit të UP-së dhe mungesës së vëmendjes së duhur në përgatitjen dhe publikimin e njoftimit paraprak për këto kontrata.

**Ndikimi** Mungesa e njoftimit paraprak nuk përkon me rregullat e prokurimit publik dhe njëkohësisht e ulë edhe transparencën për OE që të njoftohen dhe përgatiten në kohë reale për prokurimet e mundshme. Po ashtu, kjo ndikon edhe në kufizimin e UP-së që të aplikojë afatet e shkurtuara të ofertimit pa pasur nevojë për aprovim.

**Rekomandimi A6** Rektori duhet të sigurojë që njoftimi paraprak të përgatitet dhe publikohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren për Prokurim Publik.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B3 - Mos përdorimi i modulit të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave

**Gjetja** Sipas paragrafi 70.24. pika (f) të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik, funksionet e menaxherit të kontratës kërkojnë që për secilën kontratë "Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".

Procesi i menaxhimit të kontratave nuk ishte plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore pasi që kontratat e ekzaminuara nuk menaxhoheshin përmes platformës elektronike. Bazuar në mostrat e audituara ne identifikuam që për këtë pjesë menaxherët e kontratave nuk kishin

vendosur ndonjë informatë në modulën e-prokurimi edhe pse vazhdonin të ishin menaxher të kontratës. Moduli e-prokurimi nuk ishte aplikuar për asnjërën nga kontratat.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos kryerjes së punëve me përgjegjësi nga ana e menaxherëve respektivisht mbikëqyrësve të kontratave, përkundër faktit që ishte organizuar dhe mbajtur trajnim për përdorimin e modulit në sistemin elektronik.

**Ndikimi**

Mungesa e njohurive të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit e-prokurimi për menaxhimin e kontratave, ndikon në pamundësitë që menaxhmenti të marrë informata të mjaftueshme, në kohën e duhur në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi B3**

Rektori duhet të sigurojë që menaxhimi i kontratave të bëhet përmes modulit të e-prokurimit, me qëllim të mbikëqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>31,710,072</b>	<b>33,524,953</b>	<b>31,818,603</b>	<b>30,449,648</b>	<b>29,481,509</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	30,005,072	29,450,134	29,219,198	28,338,603	27,858,770
Të bartura nga viti i kaluar	0	237,228	236,833	313,797	1,889
Të hyrat vetanake	1,705,000	1,705,000	1,188,074	962,772	854,539
Donacionet vendore	0	181,867	134,354	82,753	39,447
Donacionet e jashtme	0	1,950,724	1,040,144	751,722	726,865

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,814,881€. Kjo rritje ishte me vendim të Qeverisë si rezultat i bartjes së bilancit së pashpenzuar nga viti 2023 dhe nga grantet e donatorëve.

Në vitin 2024 UP ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 31,818,603€, me një rritje prej 2% krahasuar me vitin 2023.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>31,710,072</b>	<b>33,524,953</b>	<b>31,818,603</b>	<b>30,449,648</b>	<b>29,481,509</b>
Pagat dhe mëditjet	19,583,662	19,106,325	18,784,141	18,529,985	20,950,106
Mallrat dhe shërbimet	3,812,410	6,216,735	5,280,464	4,330,655	3,919,506
Komunalitë	1,170,000	1,019,734	939,411	697,699	728,887
Subvencionet dhe transferet	1,744,000	1,861,091	1,648,531	1,363,563	824,924
Investimet Kapitale	5,400,000	5,321,069	5,166,056	5,527,745	3,058,085

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 477,337€. Ky zvogëlim ishte me vendime të Qeverisë për tërheqjen e mjeteve të kursyera, të pa shpenzuara nga kjo kategori. Shpenzimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 98%;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 2,404,325€ nga ri alokimet dhe ri destinimet e brendshme në buxhet për të mbuluar shpenzimet nga kjo kategori, me aprovim të Qeverisë. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte 85%;
- Buxheti final për komunalitë ishte zvogëluar për 150,266€. Shpenzimi nga buxheti për këtë kategori ishte 92%;
- Buxheti për kategorinë e subvencione dhe transfere ishte rritur për vlerën 117,091€, nga i cili ishin shpenzuar 89%; si dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 78,931€, si rezultat i mos shpenzimit të fondeve. Shpenzimet ishin 97% të buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga UP në 2024 ishin në vlerë 1,280,838€. Ato kanë të bëjnë me participimet, shitja e shërbimeve të institutit të inxhinierisë mekanike për ekspertizë, taksa tjera administrative.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,740,252</b>	<b>1,740,252</b>	<b>1,280,838</b>	<b>1,374,654</b>	<b>1,530,124</b>
Të hyrat jo tatimore	1,740,252	1,740,252	1,280,838	1,374,654	1,530,124

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të UP-së ka rezultuar me katër (4) rekomandime. UP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim ishte zbatuar dhe tri (3) ende nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Rektori duhet të ndërmarrë veprime për identifikimin e pronave dhe evidentimin e tyre në regjistër, me qëllim që të gjitha pasuritë kapitale që i takojnë dhe janë në shfrytëzim të UP-së të përfshihen në regjistrat e pasurive dhe të prezantohen në PFV për vitin 2024.	Gjendja e njëjtë është edhe në vitin 2024, e cila ka reflektuar në raportin e auditimit.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të sigurohet që procesi i rekrutimit të stafit realizohet brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Gjatë vitit 2024 UP nuk kishte zhvilluar procedurën e rekrutimit.	I zbatuar
3.	Investimet kapitale	Rektori duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës përdorimin e modulit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve në sistemin elektronik të prokurimit, duke siguruar menaxhim efektiv dhe transparent të tyre.	Ky modul nuk kishte aplikuar as gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Obligimet e papaguara	Rektori duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimin të faturave.	Raste të ngjashme përsëriten edhe gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Albana Kadriu, Anëtare e ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Kodi i punuar: 05-0703			
Kodi i punuar: 05-0703			
Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.
05	47	1034	1



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorah Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-p.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 11969  
Date: 18, 6, 2025

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Universitetit të Prishtinës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejme "Raportit");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Besnik Loxha,

Sekretar i Universitetit të Prishtinës

Data: 18 qershor, 2025, Prishtinë,



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.